PARLAMENTI I PARË RURAL SHQIPTAR
28-30 Shtator 2017
Universiteti Bujqësor i Tiranës

# FTESË

**Të nderuar,**

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës dëshirojnë t'ju ftojnë në **Parlamentin e Parë Rural Shqiptar, i cili do të zhvillohet më 28-30 shtator 2017 në Tiranë, në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës.** Parlamenti Rural Shqiptar zhvillohet nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

**Parlamenti i Parë Rural Shqiptar** (PRSH I) synon të sjellë bashkë aktorë të zhvillimit rural me qëllim përshpejtimin e axhendës rurale shqiptare, nëpërmjet zbatimit të një qasjeje me karakter gjithëpërfshirës, nga poshtë-lart dhe mbarëkombëtar. Përfituesit kryesor të kësaj përpjekje advokuese janë institucionet e qeverisjes qëndrore dhe vendore, si dhe aktorë të tjerë publik dhe privat, organizatat e shoqërisë civile, sipërmarrësit në fushën e zhvillimit rural etj. Ky event i cili mirëpret rreth 300 pjesëmarrës nga 61 bashkitë e vendit, organizohet në kuadër të përpjekjes së përbashkët të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural që përbëhet nga njëzet e dy OSHC lokale në partneritet me Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ju lutem gjeni bashkangjitur Programin e Parlamentit të Parë Rural Shqiptar.

Për sa më sipër, kemi kënaqësinë t'ju ftojmë të merrni pjesë në këtë event, **duke ju lutur të nominoni personin përgjegjës për politikat e zhvillimin rural në institucionin tuaj,** i cili duhet të **konfirmoj pjesëmarrjen brenda datës 22 Shtator 2017,** duke plotësuar **Formën e Regjistrimit** në linkun bashkangjitur. Pjesëmarrja në këtë event është falas. Organizatorët do të ofrojnë akomodim dhe ushqim për një pjesë të pjesëmarrësve* që ndjekin rregullisht sesionet e eventit.

Më shumë informacion rreth eventit dhe regjistrimit mund të gjeni në http://anrd.al/category/parlamenti-pare-rural-shqiptar/

Ju mirëpresim!

*Për pjesëmarrësit nga qyteti i Tiranës, Elbasanit, Durrësit, dhe zona të tjera të afërta nuk do të mbulohet akomodimi, me përjashtim të pjesëmarrësve që janë nga fshatrat e largëta të këtyre zonave.